



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:067028

Datë: 05.12.2023

Numri i dokumentit: 05017134

P.nr. 279/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taraniš, në çështjen penale kundër të pandehurës M.D.nga Peja, për shkak të dyshimit të bazuar mirë së ka kryer veprën penale “Sulm” nga neni 184 par. 3 nën par. 3.1 e lidhur me par. 1 të KPRK-së, e duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm nën shenjen PP/II Nr. 635/21 dt. 10.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 09.11.2023 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurës M.D.dhe mbrojtësit të saj av. Shaban Shala nga Peja, sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 05.12.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura:

M.D, me nr. personal e lindur më, në Pejë, ku edhe banon rr. B.K., nr.66, e bija e Sh dhe nënës F e gjinisë K, amvise, e divorcuar, nënë e 6 fëmijëve, ka të kryer shkollën e fillore, e gjendjes së dobët ekonomike, nr. tel....., e pa dënuar me pare nga gjykata, Shqiptare, shtetase e RKS-se, mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTORE

Për shkak së:

Me datën rreth orës 16:00 në Pejë, rr. “Z.P.”, me dashje, përdor forcën ndaj viktimës së ndjeshme dhe atë ndaj të dëmtuarës/të F.G.e lindur me datën, në atë mënyrë që, pas një fjalosje mes të dëmtuarës me vajzën e të pandehurës, kjo e fundit me datën dhe kohën e lartcekur, sapo e takon të dëmtuarën, fillon ta sulmoj duke e goditur, kapë për kokë e më pas e shtyn dhe e cila rrëzon,

- me këtë ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer vepër penale “**Sulmi**” nga neni 184 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, ne bazë të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 49, 69, 70, nenit 184 par. 3 nën par. 3.1 dhe par. 1, të KPRK-së, nenit 364, 449, 452, 462 të KPPRK-së, të pandehurën e:

G J Y K O N

I. Me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë (180) ditësh, e të cilin dënim pandehura nuk do ta mbajë nëse brenda periudhës së verifikimit prej dy (2) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.

II. Nëse e pandehura brenda periudhës së verifikimit kryen veprë tjetër penale, dënimi nga pika I të këtij dispozitivi, respektivisht dënimi i kushtëzuar me burgim prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh do të revokohet dhe do të zëvendësohet me burgim efektiv.

III. E pandehura obligohet që gjykatës të paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej njëzet (20) euro, dhe shumën prej njëzetë (20) euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit.

IV. E dëmtuara F.G., Rruga e P. Komuna Pejë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me dt. 10.04.2021 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II Nr. 635/21 kundër të pandehurës M.D. nga Peja, për shkak të dyshimit të bazuar mirë së ka kryer veprën penale “Sulm” nga neni 184 par. 3 nën par. 3.1 e lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me dt. 09.11.2023 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, e konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, e pandehura M.D. si dhe mbrojtësi i saj av. Shaban Shala nga Peja sipas autorizimit.

Në këtë seancë, pasi që gjykata të pandehurës i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në procedurën penale sipas KPP-së, e njëjta ka deklaruar së i ka kuptuar këto të drejta, ndërsa për mbrojtës ka angazhuar avokatin prezent dhe është konsultuar me të paraprakisht.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, gjykata është bindur se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën dhe njëjtës i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të pandehurën për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe e pandehura M.D.ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranon fajësinë, për veprën penale që i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale „Sulmi” nga neni 184 par. 3 nën par. 3.1 dhe e lidhur me par. 1 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, Prokurori i Shtetit ka deklaruar së nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, të deklaruar nga ana e të akuzuarës, pasi që e njëjta ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, e po ashtu me pranimin e fajësisë është pajtuar edhe mbrojtësi i të pandehurës duke shtuar së ky pranim i fajësisë bërë në mënyrë vullnetare, dhe ka kërkuar nga gjykata që pranimi i fajësisë të aprovohet.

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, së një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, së pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë *Akt ekspertimi mjeko ligjor ref: dt. 04.04.2021; Raporti i oficerit E.LKPS dt. 06.02.2021; Raporti i oficerit F.G.K.I. 10703 dt. 06.02.2021; Raporti mjekësor në emër të të dëmtuarës F.G.nr.dt. 06.02.2021, lëshuar nga Spitali Regjional në Pejë – Emergjencia; dhe CD me video incizim.* Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjale nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit lidhur me rrethanat lehtësuese dhe renduese deklaroi së ne kuptim të rrethanave renduese i propozoj gjykatës që të merr parasysh dënimet eventuale të mëparshme ndërsa si rrethane lehtësues të merret pranimi i fajësisë.

Mbrojtësi i të pandehurës, av. Shaban Shala, lidhur me rrethanat lehtësuese dhe renduese deklaroi së meqenëse e mbrojtura e tij ka pranuar veprën penale në mënyrë vullnetare, e që këtë pranim e ka bërë edhe në fazat e mëhershme të procedurës penale në polici, prokurori si dhe në shqyrtim fillestar, ka qenë komunikuese me organet e drejtësie është e gatshme që të kërkojë falje palës e dëmtuar dhe është hera parë që bie ndesh me ligjin. Nga të lartë cekurat i propozoj gjykatës ti merr si rrethana lehtësuese dhe të mbrojturës sime ti shqiptoj dënim sa më të bute, të kushtëzuar me qëllim që të arrihet qëllimi i dënimit e njëjta nuk do të përsëris veprën tjetër penale.

E pandehura M.D.ka deklaruar së pajtohet me deklarimin e mbrojtësit të saj dhe nuk ka çfarë të shtoj.

Prandaj, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në

veprimet e të pandehurës, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të „Sulmi” nga neni 184 par. 3 nën par. 3.1 e lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te e pandehura ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që ka qenë e vetëdijshme për veprën e kryer penale dhe e ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale e të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjyqtarja e vetme gjykuese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese mori pranimin e fajësinë, si rrethanë lehtësuese po ashtu morri pendimin dhe keqardhjen e shfaqur gjatë seancës, faktin së më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, gjendjen e dobët ekonomike, ndërkaq nga rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret gjeti së vepra është kryer ndaj viktimës së ndjeshme – viktimës së mitur.

Gjykata duke u bazuar në nenin 71 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.3, të pandehurës i shqiptoi dënim nën kufirin e paraparë ligjor, meqenëse e pandehura që nga fazat fillestare të procedurës e ka pranuar fajësinë, e po ashtu në seancë shprehi keqardhje, e duke marr parasysh karakteristikat personale të pandehurës ku gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarën e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të saj dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me kusht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u morr në përputhje me nenet 47, 48, 49, 71 e lidhur me nenin 184 par. 3 nën par. 3.1 e lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Vendimin mbi zëvendësimin e dënimit me kusht në dënim burgimi në rast se e pandehura brenda periudhës së verifikimit kryen vepër tjetër penale u morr në përputhje me nenin 50 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nënpar.2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që e dëmtuara të udhëzohet në kontest të rregullt civil, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform dispozitës së nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
Divizioni Penal
P.nr.279/21, me datë 05.12.2023

Zyrtari ligjor,

Alan Taraniš

Gjyqtarja e vetme gjykuese,

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.